

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **Korporata Energjetike e Kosovës sh.a**

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Nr ¹ i prokurimit	KEK-24-3357-1-1-1
Nr i brendshëm	KEKO 24 090 111

Sa i përket tenderit për: **"Furnizim me Acidi klorhidrik".**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

Grupi i "Conex" L.L.C & "Dini" sh.p.k
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Prishtinë

(Adresa)

Prishtinë

10000

(Vendi)

(Kodi postar)

049500080

N/A

(Numri Telefonit)

(Numri i Faks-it)

Dardan Fetahi

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

l.l.c.conex@gmail.com

(Adresa elektronike)

14.07.2025

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

2. Identifikimi i avokatit

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit



Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi për kontratë 05.04.2024
Hapja e ofertave: 15.05.2024
Vendimi AK- me datën 05.07.2024
Kërkesa për rishqyrtim dt.10.07.2024
Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim:15.07.2024
Ankesa në OSHP dt. 25.07.2024
Ekspertiza dt.08.08.2024 Nr.2024/0671
Vendimi i OSHP-së dt.20.09.2024 Nr.2024/0671
Njoftimi mbi vendimin e AK: 11.11.2024
Kërkesa për rishqyrtim: 15.11.2024
Vendimi për refuzim 25.11.2024
Ankesa dt.04.12.2024
Vendimi i OSHP-së Nr. 2024/1173 dt.30.01.2025
Njoftimi mbi vendimin:17.03.2025
Kërkesa për rishqyrtim dt.20.03.2025
Vendimi për aprovim të pjesërishëm të kërkesës për rishqyrtim dt.27.03.2025
Njoftimi mbi vendimin:27.06.2025
Kërkesa për rishqyrtim: 02.07.2025
Vendimi për refuzim 04.07.2025

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po ☐

Jo ☒

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po ☒

Jo ☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs të Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënie të Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Neni 1 i LPP-së

Neni 6 i LPP- së

Neni 52 i LPP- së

Neni 56 i LPP- së

Neni 59 i LPP- së

Neni 60 i LPP- së

Neni 62 i LPP- së

Neni 72 i LPP- së

Neni 34 i Rregullores për Prokurim Publik 001/2022

Neni 40 i Rregullores për Prokurim Publik 001/2022

Neni 43 i Rregullores për Prokurim Publik 001/2022

Vendimi Nr. 2024/0671 i dt.20.09.2024

Vendimi Nr. 2024/1173 i dt.30.01.2025

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Fillimisht sqarojmë se ky aktivitet i prokurimit është duke u zvarritur me veprimet e AK-së dhe me mosrespektimet e vendimeve të OSHP-së.

- Fillimisht ishte nxjerr njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratë ku ishte rekomanduar për kontratë Operatori Ekonomik N.T.SH. “Bizun kurse ne ishim eliminuar për çështje të TVSH-së.

Pas ankesës që kishim parashtruar ishte nxjerr **vendimi i OSHP-së Nr.2024/0671 me dt.20.09.2024**, ku ishte konfirmuar përgjegjshmëria e ofertës tonë dhe ankesa ishte aprovuar kurse lënda ishte kthyer në rivlerësim.

- Më pastaj ishte nxjerr njoftimi mbi vendimin për dhënie të kontratës ku ishte rekomanduar për kontratë **përsëri Operatori Ekonomik N.T.SH. “Bizun**, ndërsa neve na shpall tenderues i pasuksesshëm kinse kemi ofertuar me çmim më të shtrenjtë se sa oferta e OE të rekomanduar për kontratë edhe pse kjo çështje ishte sqaruar me vendimin e OSHP-së 671/2024 ku ishte konstatuar se TVSH-ja lejohet të korrigjohet dhe pas korrigjimit oferta jonë është me çmim më të ulët se sa oferta e OE N.T.SH Bizun.

Pas kërkesës për rishqyrtim dhe ankesës së dorëzuar në OSHP (me dt.04.12.2024) me **dt.30.01.2025** ishte nxjerr **vendimi i OSHP-së Nr. 2024/1173**, ku ishte aprovuar përsëri ankesa dhe lënda është kthyer në rivlerësim.

Pas rivlerësimit, me **dt.17.03.2025** kemi pranuar njoftimi mbi vendimin B58 ku **është anuluar** ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se nuk ka ofertues të përgjegjshëm, ndërsa ne kemi pranuar letrën standarde për tenderues të eliminuar me arsyetimin si në vijim:

Tenderi juaj është vlerësuar me kujdes sipas kushteve dhe kërkesave të dhëna në njoftimin e kontratës dhe në dosjen e tenderit. Me keqardhje ju njoftojmë se jeni eliminuar për shkak të arsyeve në vijim:

- **Keni munges në disa periudha në vazhdim të validitetit**

- 01.12.2024 - 17.12.2024 – 17 dite
- 18.01.2025 - 21.01.2025 – 4 dite
- 22.02.2025 - 23.02.2025 – 2 dite

Kjo arsye e eliminimit ishte plotësisht e pa bazuar dhe në kundërshtim me legjislacionin e prokurimit publik.

Pas kërkesës për rishqyrtim e cila ishte aprovuar lënda ishte kthye në rishqyrtim dhe që nga dt.27.03.2025 e deri më tani me dt.27.06.2025 nuk është bërë rivlerësimi.

- Njoftimi mbi vendimin është publikuar me dt.27.06.2025 ku është anuluar përsëri ky aktivitet i prokurimit me arsyetimin se ka qenë e pamundur të bëhet vlerësimi, ekzaminimi dhe krahasimi objektiv i ofertave dhe trajtim të barabartë të operatoreve ekonomik konkurrues.

Ky arsyetim është më të vërtetë abstrakt dhe tendencioz, pasi që të zgjatet rivlerësimi i ofertave prej dt.27.03 deri me dt.27.06.2025 dhe të nxjerret një vendim i tillë nuk mund të quhet ndryshe se përveç se shkelje e hapur ligjore dhe tendencë diskriminimi ndaj kompanisë tonë, sidomos kur kem parasysh faktin se ne jemi ofertuesi më i lirë dhe i përgjegjshëm.

Kemi shkelje të afateve të vlerësimit të ofertave. Neni 40.3 i RRPP Nr.001/2022 e përcakton qartë:

40.3 Procedura për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, dhe nxjerrja e njoftimit mbi vendimin e AK, do të kryhet nga AK brenda periudhës më të shkurtër të mundshme kohore dhe jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave. Vetëm në raste të jashtëzakonshme dhe të arsyetuara, në veçanti për kontratat e një natyre komplekse, kjo periudhë mund të zgjatet për një afat shtesë prej 20 ditësh. Procesi i vlerësimit të tenderit do të fillojë menjëherë pas përfundimit të procesit të hapjes së tenderëve.

Arsyeja e eliminimit tani është shkruar si më poshtë:

ARSYETIM

- Pas verifikimeve të bera, Autoriteti Kontraktues ka konstatuar se laboratorit që ka leshuar certifikatën e analizave "Institut og general and physical chemistry" Beograd, nuk është i akredituar për analizat e kimikaleve por vetëm të analizave të ujit. Andaj oferta juaj **nuk është në pajtueshmëri** me aspektin teknik sa i përket analizave pasi që me rastin e liferimit do të ketë kufizime apo largime që do të afektonin parametrat e cilësive, pasi që certifikata e prezentuar është jo kredibile nga një laborator që nuk është kredibil dhe nuk është i akredituar për analiza të kimikaljeve dhe e njëjta ka kufizime në besueshmërinë e specifikave teknike të acidit. Kjo është e parapare legjislationin për prokurim publik, konkretisht në RRPP, neni 40.7, paragrafi (ii), si në vijim:
"Në pajtueshmëri" nga aspekti administrativ dhe teknik duhet të kuptohet si përmbushje e kërkesave dhe e specifikimeve administrative dhe teknike të parashtruara në dosje të tenderit duke mos u larguar në mënyrë thelbësore nga ato dhe duke mos u bashkangjitur atyre kufizime.

"Largime dhe kufizime thelbësore janë ato të cilat:

(ii) Afektojnë parametrat, cilësinë ose ekzekutimin e kontratës;

- Përveq tjerash pas verifikimeve të bera dhe pranimit të përgjigjeve nga prodhuesi 'Borsodchem' të cilin konzorciumi juaj e ka paraqitur në oferte si prodhues i acidit, është konstatuar se konzorciumi juaj nuk ka marrë oferte nga prodhuesi Borsodchem për të dorëzuar tenderin e tij në këto aktivitete të prokurimit. Andaj oferta e juaj **nuk është në pajtueshmeri** nga aspekti administrativ pasi që kjo situatë potencialisht krijon kufizime thelbësore për përmbushjen e kontratës, siç parashifet në nenin e lartecukur të RRPP (neni 40.7, paragrafi ii).

Para se ti shtjellojmë arsyet e eliminimit, sqarojmë se pas qasjes në dokumentacion kemi vërejt se ka qenë edhe **një raport i vlerësimit i dt.16.05.2025**, ku kryetari i komisionit ka shfaqur tendencë hapur ndaj kompanisë tonë duke na cilësuar të papërgjegjshëm, ndërsa dy anëtarët tjerë të komisionit e vlerësojnë të përgjegjshme ofertën tonë dhe na kanë rekomanduar për kontratë, mirëpo këtë rekomandim të dy anëtarëve të komisionit nuk e ka aprovuar ZPP dhe lëndën e ka kthyer në rishqyrtim.

Arsyeja e eliminimit është e pabazuar, sepse Instituti për Kimi të Përgjithshme dhe Fizike në Beograd është institucion publik, me status ligjor të përcaktuar qartë dhe me akreditim të vlefshëm ndërkombëtar sipas standardit ISO/IEC 17025:2017.

Ky standard përcakton kërkesat për kompetencën teknike të laboratorëve, dhe në nenin 3.6 e përkufizon qartë laboratorin si njësi që kryen analiza testuese, kalibrime apo marrje mostrash, përfshirë analiza kimike siç është acidi klorhidrik. Për më tepër, neni 7.2 dhe konkretisht pika 7.2.1.4 saktëson që në rast se klienti nuk e përcakton metodën, laboratori ka të drejtë dhe kompetencë të zgjedhë metodën e duhur për testim, përfshirë ato të publikuara nga organizata teknike të njohura apo standarde ndërkombëtare si SK EN 939:2018 – e pikërisht këtë ka zbatuar laboratori për raportin e dorëzuar nga OE.

Është pjesë të kësaj lëndë edhe një konfirmim nga laboratori ku znj. Mirvete Gërguri kishte kërkuar sqarime. Konfirmimi i dt.09.05.2024 është sqarim për KEK por që tani nuk është analizuar fare, ndërsa kërkojmë nga ekspertit shqyrtues që të analizohet ky konfirmim zyrtar.

Ky arsyetim ishte ngritur nga kryetari i komisionit z. Afrim Imeraj i cili në raportin e vlerësimit të dt.16.05.2025 ka deklaruar si më poshtë:

Kryetari i komisionit z. Afrim Imeraj ka vlerësuar si mëposhtë:

Grup i Operatorëve Ekonomik CONEX L.L.C.; DINI SH.P.K.

OE ka dërguar një dokument i cili shkruan të jetë "results of analysis" i cili është lëshuar nga Institute of General and Physical Chemistry, në Beograd. Në dosjen e tenderit është kërkuar që të dërgohet Certifikatë e analizave, dhe dokumenti i dërguar në këtë rast nga GOE nuk i përgjigjet kërkesës për certifikatë të DT.

Për më tepër, gjatë kërtimeve të komisionit të vlerësimit në internet në [LINK](#), Instituti që ka lëshuar dokumentin në fjalë, rezulton të jetë i akredituar për analiza të ujërave dhe askund nuk shkruan të jetë i akredituar për analiza të produkteve të tjera:

"The laboratory for testing, research and development of the Institute of General and Physical Chemistry is accredited for physical and chemical testing of water (water, drinking water, surface water, underground water, waste water) in accordance with the requirements of the SRPS ISO/IEC 17025:2017 standard under accreditation number 01-525."

Ndërsa dy anëtarët e komisionit kanë dhënë mendimet e tyre si më poshtë:

Anëtarët e Komisionit të vlerësimit z. Zeqir Gashi dhe z. Bledar Racaj kanë vlerësuar si mëposhtë:
Operatorët Ekonomik të cilat kanë ofertat valide plotësojnë kërkesat e dosjes së tenderit.

Lidhur me ofertën e **Grupit të Operatorëve Ekonomik CONEX L.L.C.; DINI SH.P.K.**

Ne webfaqe shkruan se instituti bene analiza fiziko- kimike, përveç kësaj ne sqarimet qe kane qene para hapjes është cekur qe “Sa i përket certifikatës së analizës sipas standardit SK EN 939:2018 për acid klorhidrik (31-33%) (tip 1), mund të jetë data kur malli ngarkohet nga prodhuesi” qe nënkupton se kjo certifikatë ka mundur të mos dorëzohet fare në këtë fazë por gjatë implementimit. Njehërit komisioni ka siguruar edhe një komunikim nga ish u.d. Zyrtari përgjegjës i prokurimit znj. Mirvete Gerguri me një konfirmim nga laboratorit se RAPORTI I ANALIZËS është bërë në mostrën e prodhuesit Borsod Chem, me datë 09.05.2024, dhe këto rezultate gjithashtu kanë konfirmuar se produkti është në përputhje me standardin SK EN 939:2018.

Pretendimet se OE "CONEX SHPK" ka dorëzuar një dokument të dyshimtë, me arsyetimin se ky i fundit nuk ka një ofertë nga prodhuesi si dhe mbështetje gjatë tre viteve, vlerësoj se ky pretendim nuk është relevant në këtë rast. Kjo sepse, në dokumentet e dosjes së tenderit, Autoriteti Kontraktues (AK) nuk ka kërkuar ndonjë deklaratë apo garanci nga prodhuesi për mbështetje gjatë tre viteve pas nënshkrimit të kontratës (ka logjike qe nuk është kërkuar sepse kjo kuptohet se OE në momentin e nënshkrimit të kontratës hynë në obligime kontraktuale) si dhe nuk është kërkuar as ndonjë autorizim nga prodhuesi.

Gjithashtu, në dosjen e tenderit janë paraparë mekanizma sigurie si: sigurimi i ekzekutimit të kontratës në rast të mosrespektimit të kushteve të kontratës nga ana e Operatorit Ekonomik.

Kërkimi i një aprovim nga prodhuesi në këtë fazë do të ishte jashtë kërkesave të përcaktuara në dosjen e tenderit dhe do të komplikonte procesin. duke krijuar një situatë jo reale pasi qe kemi të bëjmë me OE të cilat kanë paraqitur prodhuesin e njejtë dhe në rast të tillë do të ishte një luftë e konkurrencës (duke ndikuar tek prodhuesi) dhe mendoje se mund të demtohet financiarisht edhe AK.

Përveç kësaj është siguruar edhe një komunikim nga ish u.d. Zyrtari përgjegjës i prokurimit znj. Mirvete Gerguri me një konfirmim nga laboratorit për OE Conex SHPK se RAPORTI I ANALIZËS është bërë në mostrën e prodhuesit Borsod Chem, me datë 09.05.2024, dhe këto rezultate gjithashtu kanë konfirmuar se produkti është në përputhje me standardin SK EN 939:2018.

Si përfundim:

Në dosjen e tenderit nuk është kërkuar autorizim nga prodhuesi;

Të gjithë operatorët ekonomikë kanë dorëzuar deklaratat nën betim

Ne sqarimet qe kane qene para hapjes është cekur qe “Sa i përket certifikatës së analizës sipas standardit SK EN 939:2018 për acid klorhidrik (31-33%) (tip 1), mund të jetë data kur malli ngarkohet nga prodhuesi” qe nënkupton se kjo certifikatë ka mundur të mos dorëzohet fare në këtë fazë por gjatë implementimit.

Bazuar në vendimet e OSHP-se me numer 2024/0671 të datës 20.09.2024 dhe vendimin nr. 2024/1173 të datës 30.01.2025, oferta Grupit të Operatorëve Ekonomik CONEX L.L.C.; DINI SH.P.K. është oferta me e lire pjesëmarrëse në këtë procedurë të prokurimit

Nga ky raport i vlerësimit kuptohet qartë tendenca e kryetarit të komisionit i cili shpërfaq tendencën ndaj kompanisë tonë edhe pse gjithçka është e qartë se ne i plotësojmë të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Ish Kryetari i komisionit, z. Afrim Imeraj, duke deklaruar se ky institut “është vetëm për analizë të ujit”, duke injoruar faktin që sipas nenit 7.2.1 të ISO 17025:2017, laboratorët kanë të drejtë të zgjedhin metoda të vlefshme sipas praktikës së njohur shkencore, ndërsa në pikën 7.2.1.4 theksohet qartë se laboratorët mund të përdorin edhe metoda të prodhuesit të pajisjeve, nga organizata teknike apo revista shkencore – dhe një raport që vërteton përputhshmërinë me SK EN 939:2018 nga një laborator i akredituar është më se i vlefshëm ligjrisht dhe teknikisht.

Gjithashtu, në dokumentet e tenderit **nuk është kërkuar** që certifikata SK EN 939:2018 të dorëzohet në ofertë, por vetëm posedimi i saj nga prodhuesi. Ne kemi dorëzuar një raport konformiteti për produktin, i lëshuar nga laborator i akredituar, siç lejohet edhe nga vetë praktika dhe standardet ndërkombëtare. Ky raport është pranuar më herët edhe nga zyrtarja e prokurimit, znj. Mirevete Gerguri.

Për më tepër, edhe dy anëtarë të komisionit vlerësues, z. Zeqir Gashi dhe z. Bledar Racaj,

kanë konstatuar që certifikata SK EN 939:2018 mund të kërkohej në fazën e implementimit dhe jo domosdoshmërisht në ofertë, prandaj vlerësimi i bërë nga kryetari i komisionit është i njëanshëm dhe në kundërshtim me vetë parimet e ISO 17025 dhe me dokumentacionin e tenderit.

- **Sa i përket arsyes së eliminimit se ne nuk kemi marr ofertë nga prodhuesi Borsodchem**

Faktin se nuk është kërkuar në dosje të tenderit të ofrohet ndonjë ofertë apo autorizim nga prodhuesi, këtë e kishin konstatuar edhe në Raportin zyrtar të komisionit të datës 28.04.2025 (Raporti nr. 1), i hartuar nga Zyrtari i Prokurimit z. Bledar Racaj dhe anëtarë i komisionit z. Zeqir Gashi, ku konstatohet qartë se:

AK nuk ka kërkuar ndonjë deklaratë apo garanci nga prodhuesi për mbështetje gjatë tre viteve pas nënshkrimit të kontratës dhe nuk është kërkuar as ndonjë autorizim nga prodhuesi.

Pra nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë në FDT në lidhje me këtë çështje, prandaj nuk mund të eliminohej për një kërkesë që nuk ka qenë e përcaktuar në dosje të tenderit dhe me këtë rast AK-së ka vepruar në **kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.**

Megjithatë, në Raportin e mëvonshëm të vlerësimit i përpiluar nga Zyrtari i Prokurimit z. Emin Tmava, dhe anëtarët e rinj të komisionit Marte Raja dhe Qemajl Rexhepi, është bërë një vlerësim krejtësisht i ndryshëm dhe në kundërshtim me raportin e parë. Aty konstatohet se për shkak se OE nuk ka marrë ofertë direkte nga prodhuesi Borsodchem, atëherë krijohet një “mos pajtueshmëri administrative”. Ky qëndrim jo vetëm që bie në kundërshtim me kërkesat e dosjes së tenderit por është tejkalim i kompetencave, sepse asnjë kërkesë e tillë nuk është paraparë në dokumentacionin e tenderit.

Të gjitha këto kundërtënie të raporteve të vlerësimit, rivlerësimit e qëndrime të ndryshme të zyrtarëve përgjegjës dhe anëtarëve të komisionit të cilët janë orientuar kundër ofertës tonë konsiderojmë se e kanë vetëm një qëllim dhe **atë favorizimin e OE NTSH Bizun**, ku duke **i vonuar proceset e vlerësimit dhe të rivlerësimit po ia mundësojnë kësaj kompanie të fitojë tender të negociuar për acid klorhidrik.**

Negocimi që tri herë është duke ndodh me të vetmin operator ekonomik NTSH Bizun, ndërsa ne nuk ftohemi në negociata edhe pse jem tenderues i përgjegjshëm dhe me çmim më të ulët në procedurën e rregullt të prokurimit. Dyshojmë shumë se të gjithë këta zyrtarë që po veprojnë në këtë mënyrë janë të përfshirë në procesin e kurdishjes, përfitimit dhe keqpërdorimit të detyrës zyrtare, e që nëse nuk do të vendoset drejtësi tani, ne do të jemi të detyruar ti drejtohem me denoncime hetuesisë dhe njëkohësisht kallëzime penale në prokurori për këta zyrtar të cilët po tejkalojnë detyrat e tyre zyrtare me qëllimin e vetëm që të jetë fitues NTSH Bizun.

Është plotësisht i paqëndrueshëm pretendimi i AK-së se oferta jonë ka largime substanciale por sqarojmë se oferta jonë është në përputhshmëri të plotë me të gjitha kërkesat e dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë por AK-së po mundohet të përdor kërkesa që nuk janë të përcaktuara në dosje të tenderit.

Se si duhet të bëhet vlerësimi i ofertave dhe në cilat kritere duhet bazuar përcaktohet qartë edhe tek neni 40.2 i RRPP Nr.001/2022 , ku ceket si në vijim :

“Tenderët e pranuar me kohë të paraqitur nga tenderuesit do të ekzaminohen, vlerësohen dhe krahasohen në përputhje me procedurat dhe kriteret e përcaktuara në njoftimin për kontratë/dosjen e tenderit dhe kontrata do t'i jepet tenderuesit që ka renditjen më të lartë. Kështu, autoritetet kontraktuese nuk mund të ndryshojnë, modifikojnë ose heqin kërkesa të përcaktuara paraprakisht, kritere ose specifikacione ose të shtojnë disa të reja gjatë ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve”.

Me këtë dispozitë, përcaktohet qartë se autoritetet kontraktuese nuk mund të heqin, ndryshojnë, modifikojnë ose të shtojnë kritere dhe kërkesa me rastin e ekzaminimit, vlerësimit dhe krahasimit të tenderëve.

Me rastin e vlerësimit të ofertës së konsorciumit tonë **janë shtuar kërkesa, siç është kjo që ne nuk kemi marr ofertë nga prodhuesi.** Ky veprim i komisionit vlerësues tregon arbitrarizëm në vlerësim dhe diskriminim për konsorciumin tonë.

Edhe pse nuk ka qenë kërkesë e dosjes së tenderit, **“oferta nga prodhuesi”** sqarojmë se prodhuesit i kanë dilerët e tyre nëpër regjione të ndryshme dhe në shumë raste ne nuk komunikojmë drejtpërdrejtë me prodhuesit por me përfaqësuesit e tyre, sikurse në këtë rast që kem marrëveshje verbale, pasi që marrëveshje e shkruar nuk është kërkuar.

Po ashtu sqarojmë se prodhuesit mund ti njohin kompanitë që kanë pasur bashkëpunim një kohe të gjatë mirëpo nuk mund të njohin kompani që ndoshta për herë të parë po themelojnë bashkëpunim me prodhuesin.

Vendimi për refuzim të kërkesës për rishqyrtim është nxjerr me dt.04.07.2025.

Në këtë vendim të AK-së shihen edhe më qartë dhe me këmbëngulje tendencat e AK-së që me çdo kusht të eliminohej nga konkurrenca.

1. Së pari, prodhuesi Borsodchem, në përgjigjen e tij zyrtarë, ka deklaruar qartë: **“Our company assigned one and only company to participate in the HCI tender with our material...”**, duke specifikuar saktësisht cilin distributor ka autorizuar për këtë procedurë prokurimi. Ky distributor ka autorizuar tjetër OE për këtë tender. OE ankimes në ofertën e tij nuk ka përmendur as distributor, as komunikim, dhe ka deklaruar origjinë dhe prodhues specifik.

“Distributori” që OE po e sjell në skenë vetëm tani, në këtë fazë të tenderimit—pas ekspozimit të faktit se nuk ka kontakt me prodhuesin e produktit të ofertuar dhe atë pas më shumë se një vit pas hapjes së tenderit, përbën justifikim të qartë dhe tendencë e hapur për manipulim, përkatësisht “ndryshim i versionit pas ekspozimit të faktit”.

*OE ka nënshkruar **deklaratën nën betim**, përmes së cilës ka deklaruar se të gjitha të dhënat e ofertës janë të sakta dhe të vërteta, dhe se përmbush kriteret e përshtatshmërisë në mënyrë të plotë. Me inkorporimin e distributorit tek tani, OE bie në kundërshtim me deklaratat e tij, nën betim, me deklaratën e tij për origjinë dhe prodhues.*

Sa i përket arsyes së cekur se prodhuesi ka deklaruar se ka autorizuar vetëm një kompani për këtë tender, sqarojmë se në këtë dosje të tenderit askund nuk është kërkuar autorizim nga prodhuesi apo dileri, prandaj përpjekja e AK-së për tu arsyetuar në këtë mënyrë është tendencë manipuluese me kërkesa që nuk kanë qenë në dosje të tenderit dhe me këtë rast dhe me këtë përgjigje po veprohet në kundërshtim me nenin 56.3 të LPP-së.

Nuk ka asnjë rëndësi në këtë rast a kem biseduar me dilerin apo prodhuesin apo me asnjërin sepse nuk është kërkuar autorizim nga prodhuesi.

Autoriteti kontraktues duke e ditur mirë faktin se OE Bizun bashkëpunon me këtë prodhues që një kohe dhe duke e pasur parasysh se vetëm kjo kompani ka qenë fituese e tenderëve të acidit në KEK normalisht duke ia përgatitur terrenin zyrtarët e KEK ut dhe duke pasur parasysh që tani po rrezikohet interesi i kompanisë Bizun e dyshojmë se po iu rrezikohet edhe interesi i ndonjë zyrtari të KEK përdorin arsye të eliminimit të pa bazuara dhe të paqëndrueshme, madje tendencioze.

Tendenca manipuluese e KEK vërehet edhe tek përgjigja si më poshtë:

Komisioni i Rivlerësimit me qëllim të sqarimit të pretendimeve të ngritura në komisionin paraprak, ka kërkuar zyrtarisht me email dy herë nga Instituti të dërgojë akreditimin e laboratorit për analiza të kemikalieve, mirëpo brenda mandatit të vet nuk ka pranuar përgjigje në këtë kërkesë. Kontaktimet me Institutin janë realizuar në datat: 05.06.2025 dhe 11.06.2025, në email zyrtare të publikuara në ëebfaqe të institutit. Në ditën e fundit të afatit të parashtrimit të ankesave për rishqyrtim, 02.07.2025, OE kontakton Institutin (dhe atë në email privat!) me kërkesën e njejtë sikurse komisioni, dhe Instituti i përgjigjet duke dërguar dokumente, gjë të cilën nuk e ka bërë dy herë kur komisioni i ka kërkuar zyrtarisht. Kjo ngrit dyshimet për ndikim të OE tek instituti me qëllim pengimin dhe manipulimin e procesit të verifikimit të komisionit të vlerësimit! Dokumentet e dërguara nga instituti edhe publikimit të rezultateve të rivlerësimit, e forcojnë edhe më shumë bindjen e komisionit që instituti nuk ka akreditim për analiza të kemikalieve përkundrazi tregojnë akreditimin e laboratorit për kërkime shkencore.

Kjo përgjigje është plotësisht manipuluese dhe tendencioze sepse nga komunikimi ynë që kemi bërë me laboratorin i kemi vënë në CC edhe zyrtarët e KEK dhe anëtarët e komisionit dhe nuk ka asgjë këtu private po janë komunikime zyrtare me zyrtar përgjegjës të laboratorit, ndërsa ne nuk e dimë se kujt i janë drejtuar zyrtarët e KEK apo a i janë drejtuar më të vërtet me ndonjë shkresë dikujt.

Shih më poshtë emailin tonë:



CONEX L.L.C <l.l.c.conex@gmail.com>

Zvaničan zahtev za potvrdu o akreditaciji Instituta za hemijske analize proizvoda

CONEX L.L.C <l.l.c.conex@gmail.com>

Wed, Jul 2 at 11:35

To: <stevan.blagojevic@gmail.com>

Cc: Avdi Muzliukaj <Avdi.Muzliukaj@kek-energy.com>, Emin Tmava <emin.tmava@kek-energy.com>, Qemajl Rexhepi <Qemajl.Rexhepi@kek-energy.com>, Marte Raja <Marte.Raja@kek-energy.com>, Afrim Imeraj <afrim.imeraj@kek-energy.com>, <dinishpk@yahoo.com>

Poštovani dr Stevan Blagojević, direktore Instituta za opštu i fizičku hemiju,

Srdačno Vas pozdravljamo i nadamo se da ste dobro.

U okviru postupka javne nabavke: „Nabavka hlorovodonične kiseline“, broj nabavke KEK-24-3357-1-1-1, na osnovu odluke od 27.06.2025. godine, ugovorni organ je doneo odluku o eliminaciji naše ponude iz daljeg postupka evaluacije. Kao razlog, komisija je navela da Institut kojim Vi rukovodite vrši isključivo analize vode, a ne i fizičko-hemijske analize, te da, prema njihovim tvrdnjama, ne poseduje akreditaciju za obavljanje takvih analiza, koje su zahtevane za predmetnu nabavku.

Pra këtu kemi komunikim zyrtar, e poashtu edhe përgjigja është marr zyrtarisht dhe ju jeni të njoftuar zyrtarisht.

Bashkangjitur keni certifikatën e akreditimit e cila mban datën 25.08.2022 pra para datës së hapjes së ofertave dhe vendimin për akreditim të institutit për kimi të përgjithshme dhe fizike A.D.

Këto dokumente ne i kemi përkthyer dhe i keni të bashkangjitura edhe në gjuhën shqipe

Më tej në përgjigje AK-së shkruan si më poshtë:

-Komisioni i rivlerësimit ka shqyrtuar detajisht këto pretendime të OE, dhe konstaton që ka të pavërteta në këto pretendime: 1. Znj.Gërguri nuk ka kërkuar asnjëherë sqarime në lidhje me laboratorin dhe 2. Raport konfirmimit për produktin nuk është pranuar asnjëherë! Kjo dëshmon edhe një herë një tendencë të OE për të manipuluar faktet reale të ndodhura gjatë rrjedhës së këtij aktiviteti të prokurimit.

Komisioni sqaron që "Konfirmimi nga laboratorin" të cilit i referohet OE, është dokument i pranuar në email më 11.10.2024 nga emaili privat! i drejtorit të institutit, i cili nuk është kërkuar për asnjë moment nga AK, përkundrazi është dërguar vullnetarisht me kërkesë vullnetare nga OE. Në momentin kur është dërguar ky dokument nuk ka pasur asnjë pretendim dyshimi zyrtar mbi vërtetësinë e dokumentit dhe përmbajtjes së tij! Edhe me këtë dokument të dërguar OE ka pasur tendencë që të mbulojë mangësitë në ofertën e tij lidhur me dokumentin e analizave!

Nga ana tjetër, dokumenti që OE i referohet si konfirmim shkruan "...konfirmojme se RAPORTI I ANALIZES SE ACIDIT KLOORHIDRIK (prodhuesi: Borsod Chem, Hungari) është e njejta analize si RAPORTI I ANALIZËS bërë në mostrën e prodhuesit Borsod Chem, me datë 09.05.2024, ..." duke mos qartësuar asgjë.

Për më tepër, bazuar në përgjigjen zyrtare të prodhuesit, sjellë në vëmendje një pikë tjetër të rëndësishme: origjinën e mostrës së analizuar nga Institute of General and Physical Chemistry: "...of received sample named as: HYDROCHLORIC ACID (producer BorsodChem, Hungary), lot 0081072161."

*Megjithatë Instituti ka verifikuar autenticitetin e dokumentit të tyre, mirëpo duhet pasur parasysh disa fakte si në vijim: së pari ky është vetëm emërtim sic ceket në dokument: "...of received sample **named as:** ..." dhe së dyti duke qenë se **prodhuesi mohon zyrtarisht të njohë dhe të jetë kontaktuar nga OE me kërkesë për ofertë, rrjedhimisht edhe furnizimi i OE me mostër të produktit të këtij prodhuesi në rrugë zyrtare dhe ligjshme nuk ka pasur si të ndodhë.***

Nga kjo përgjigje kuptohet tendenca diskriminuese ndaj neve, sepse në njërin anë thuhet se është verifikuar autenticiteti i dokumenteve e në anën tjetër mundohen që të arsyetohen se prodhuesi nuk është kontaktuar nga ne. Absolutisht nuk është kërkuar ndonjë kërkesë që të dëshmohet kontakti me prodhuesin apo dilerin, prandaj çdo përpjekje për eliminim me këto dëshmi është kundërligjore dhe subjektive.

Autoriteti kontraktues e ka zhvendos vëmendjen te një çështje tjetër se a kemi pas komunikim me prodhuesin apo jo, mirëpo kjo nuk është çështje kryesore e as esenciale sepse nuk ka ekzistuar asnjë kërkesë e tillë në dosje të tenderit, prandaj as nuk ja vlen të merremi pavarësisht që i kemi sqaruar më lartë këto çështje.

Sa i përket çështjes se kinse rrezikshmërisë për këtë furnizim, sqarojmë se për AK-së çdo

kush tjetër që e fiton tenderin përjashtimisht OE të preferuar NTSH Bizun, paraqet rrezik për projektin, prandaj është shumë joprofesionale kjo qasje dhe shumë tendencioze nda kompanisë tonë, sepse me nënshkrimin e kontratë merret përgjegjësi e plotë për përfundim të projekti dhe ne e dimë këtë përgjegjësi dhe me vetëdije të plotë jemi në këtë tender e po ashtu edhe sigurimi i ekzekutimit mund të konsiderohet në rast të dështimit.

Duke pasur parasysh faktin se furnizimi me acid klorhidrik është shumë i rëndësishëm, kërkojmë nga OSHP, që të detyroj autoritetin kontraktues që të zbatoj procedurat e prokurimit konform legjislacionit të prokurimit publik dhe fakteve e dëshmime në lidhje me këtë lëndë, ku tashmë edhe me dy vendime të OSHP-së është konfirmuar se oferta jonë është e përgjegjshme e po ashtu oferta jonë është edhe më e lirë. Kur kem parasysh këto fakte duhet të rekomandohemi ne për kontratë.

Duke i pasur parasysh të gjitha faktet në lidhje me kronologjinë dhe ecurinë e këtij aktiviteti të prokurimit, rezulton se ky aktivitet i prokurimit është anuluar në kundërshtim me nenin 62 të LPP-së, sepse nuk janë përmbushur asnjëra nga kushtet e parashikuara në këtë dispozitë.

Anulimi i këtij aktiviteti të prokurimit është bërë në kundërshtim edhe me nenin 43.5 dhe 43.7 i Rregullores nr.001/2022 Për Prokurim Publik, sepse nuk janë plotësuar asnjëra nga kushtet e kësaj dispozite, ndërsa sqarojmë se ne jemi ofertues i përgjegjshëm dhe i plotësojmë të gjitha kërkesat e FDT-së dhe të njoftimit për kontratë dhe jemi me çmim më të ulët në krahasim me ofertuesit e përgjegjshëm.

Paragrafi 1 i nenit 7 të LPP-së e parasheh qartë që “Autoriteti kontraktues do ti trajtoj operatorët ekonomik në mënyrë të barabartë dhe jo- diskriminuese dhe do të veprojë në mënyrë transparente, ndërsa AK-së nuk e ka zbatuar këtë dispozitë duke na diskriminuar neve.

Po ashtu nuk është marr në konsideratë edhe neni 1 i LPP-së, pasi që dihet se qëllimi i këtij ligji është të sigurojë mënyrën më efikase, më transparente dhe më të drejtë të shfrytëzimit të fondeve publike, burimeve publike si dhe të gjitha fondeve dhe burimeve të tjera të autoriteteve kontraktuese në Kosovë.

Në fund ju informojmë se do të kërkojmë nga OSHP që konform nenit 131 të LPP-së të shqiptojë gjobë autoritetit kontraktues për mos respektim të vendimeve të OSHP-së Nr. 2024/0671 i dt.20.09.2024 dhe Vendimi Nr. 2024/1173 i dt.30.01.2025 dhe njëkohësisht do të kërkojmë që të kërkohej nga KRPP që ti revokohet licenca ZPP për shkelje e rënda që i ka bërë me rastin e mosrespektimeve të vendimeve të OSHP-së, pra që KRPP të veprojë konform nenit 99 të RRPP Nr.001/2022, sepse veprimet e AK-së hyjnë në shkeljet e rënda sipas nenit 97 paragrafi 1 pika (h) të rregullores së lartpërmendur

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga ju që të merrni:

VENDIM

- I. APROVOHET**, e bazuar ankesa e OE “Conex”L.L.C & “Dini”sh.p.k
- II. ANULOHET**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për anulim të aktivitetit të prokurimit dhe lënda kthehet në **RIVLERËSIM** dhe gjatë rivlerësimit, ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i ofertave të bëhet në harmoni me kërkesat

e dosjes së tenderit, njoftimit për kontratë dhe konform dispozitave të LPP-së.

III. URDHËROHET AK-së të zbatojë vendimin e OSHP-së Nr.2024/0671, të dt.20.09.2024 dhe Vendimi Nr. **2024/1173 i dt.30.01.2025.**

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Neve si Operator Ekonomik na janë bërë dëme materiale për përgatitjen dhe dorëzimin e ofertës, për kërkesën për rishqyrtim në vlerë prej 5,000.00 euro.

v10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) *një kopje të publikimit të “Njoftimit për Kontratë” apo “Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) *një kopje të publikimit për “Njoftimin e Dhënies së Kontratës” apo “Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimit për Anulim”.*
- c) *një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.*
- d) *një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.*

***Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.

